


Buxheti 2023

Bashkia Librazhd



Të dashur bashkëqytetarët e mi,

Buxheti 2023 që prezanton një mbështet vizionin tonë për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mbrotjen e mjedisit, me synim për ta kthyer Librazhdin në një qytet të përparuar social – ekonomik.

Ky dokument prezanton një qasje gjithëpërfshirëse ndaj realizimit efektiv të politikave zhvillimore të Bashkisë Librazhd në përputhje me informacionin financiar për të ardhurat dhe shpenzimet. Vlen të theksohet se objektivat e strategjisë së zhvillimit kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e Buxhetit 2023 duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit, me projektet e parashikuara në secilin program buxhetor të Bashkisë Librazhd. Mbi bazën e këtij parimi është ndërtuar kuadri logjik i buxhetit dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Duke bërë këtë kemi siguruar një sistem menaxhimi efikas, të përgjegjshëm dhe transparent për përdorimin e fondeve publike, kjo jo vetëm si një detyrim ligjor por edhe si një praktikë e mirë e Bashkisë Librazhd në ngritjen e një sistemi efektiv për menaxhimin financiar të fondeve publike.

Prezantimi i Buxhetit 2023 si një instrument i rëndësishëm financiar, ku objektivat e strategjisë së zhvillimit përkthehen në ndërhyrje konkrete, vjen pas një procesi të gjatë pune. Ky proces ka ecur paralelisht me harmonizimin e dokumentave strategjike që Bashkia Librazhd disponon si dhe me organizimin e një sërë takimesh konsultative me aktorë dhe palë të interesuara për të adresuar nevojat konkrete të tyre. Pjesë e pa ndarë e këtij procesi kanë qenë edhe konsultimet e tjera publike të cilat Bashkia ka ndërmarrë gjatë zhvillimit të aktiviteteve tësaj.

Synimi jonë është kthimi i Bashkisë Librazhd në një nga qendrat më të rëndësishme kombëtare, një nyje e rëndësishme transporti dhe një potencial për zhvillimin e turizmit. Në përbushje të këtij synimi Bashkia Librazhd do të fokusojë përpjekjet e saj në drejtim të garantimit të barazisë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve. Për këtë arsyë buxheti 2023 do t'i shërbejë përpjekjeve në vazhdim për të përbushur vizionin e Strategjisë Territoriale për Zhvillim 2015 – 2030 si më poshtë vijon:

- Përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke mundësuar akses të plotë për të gjithë, përmes financimit me fondet e veta, aksesit në fondet qeveritare;
- Përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve publike: menaxhimit të mbetjeve, mbrojtjes së mjedisit, ndriçimit rrugor, furnizimit me ujë të pijshëm, hapësirave të gjelbra, etj.;
- Përmirësimin e lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë;
- Përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e territorit të Bashkisë Librazhd;
- Promovimin e produkteve vendore, nxitjen e shumëlojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve;

- Projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirë administrimin e infrastrukturës së ndërtuar;
- Nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit;
- Ruajtjen dhe promovimin i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të Bashkisë Librazhd;
- Sigurimin e ambjenteve dhe mjediseve te përshtatshme arsimore, të sigurta dhe drejt përmbushjes së standartev ligjore;
- Krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminim për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, originës, minoritetit;
- Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe këshillit bashkiak.

Transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korruptionit, qeverisja me pjesëmarrje, shërbesa me etikë dhe përgjegjshmëri, ndërhyrjet me efikasitet, përdorimi me eficiencë i fondeve, Instrumentet e rinj të administritimit, përmes përdorimit të teknologjisë bashkohore, procedurave dhe rregullave që do të vijojmë të zhvillojmë, janë principet dhe mënyra e punës tonë.

Nëpërmjet këtij dokumenti synojmë të informojmë çdo banor kudo, publikun e gjerë, qeverinë dhe partnerët, lidhur me parashikimet buxhetore të shpenzimeve të Bashkisë Librazhd.

Besoj që të gjithë bashkë, me shumë punë e përkushtim, do të vazhdojmë të përmbushim përgjegjësitë për të administruar, shërbyer dhe zhvilluar Librazhdin.

Unë besoj në kontributin dhe mbështetjen tuaj!

Kastriot GURRA

KRYETAR

Ministrat
qeverisës
Bashkisë
Librazhd
Përgjigjet
dhe
përfundim

Urdhë
Ministrat
qeverisës

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM



MISIONI I BASHKISË LIBRAZHD

Bashkia Librazhd ka përmision hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave, ushtrimin efektiv të funksioneve dhe kompetencave, ofrimin dhe realizimin e shërbimeve bazuar në nevojat e komunitetit në përputhje me kuadrin ligor në Republikën e Shqipërisë.

ORIENTIMI AFATGJATË

Bashkia Librazhd në 2030 do të jetë një ndër qendrat e rëndësishme kombëtare, një nyje e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një korridor i rëndësishëm transporti. Pozicioni gjeografik i vendodhjes së bashkisë Librazhd e bën atë që të jetë një zonë e rëndësishme ekonomike dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajkoneve natyrore, ndërkufitarë e turistike.

Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve. Një qendër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat turistike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Librazhd. “Librazhdi, qytet rajonal” sfida dhe objektivi kryesor i viteve në vazhdim.

Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuren me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi që është gjithmonë në rritje nga viti në vit do të jetë një vlerë e shtuar në ekominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor, malor e ujor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.

Librazhdi me një mjeshtëri pastër e cilësor, një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi.

Buxheti 2023

Buxheti është tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore të planifikuar, miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e bashkisë.

Buxheti i Bashkisë Librazhd për vitin 2023 është parashikuar të jetë 654,659,440 lekë nga të cilat 166,010,000 ose 25,3 % vijnë nga **taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Librazhd**, 330,723,278 ose 50.5% vijnë nga **transferta e pakushtëzuar**, 157,075,162 ose 24% vijnë nga **transferta e pakushtëzuar sektoriale**.

Ky buxhet është hartuar në zbatim të legjislacionit të mëposhtëm:

- a. Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- b. Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisen vendore”
- c. Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë ”ndryshuar.
- d. Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- e. Ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- f. Ligjit 10296/2010 “Për menaxhimin finanziar dhe Kontrollin”
- g. Ligjit 10405, “Për Kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërbllimeve”
- h. Udhëzim i Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde te përgatitjes se Programit Buxhetor Afatmesëm”
- i. Udhezimin nr.8 date 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2023-2025”.
- j. Udhezim plotësues nr.23 date 08.07.2022 “Per pergaatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2023-2025”.
- k. VKM nr.625, date 28.09.2022,”Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr 165,date 02.03.2016 .
- l. VKM nr.627,date 28.09.2022,”Per disa ndyshime ne VKM nr 234,date 20.04.2022,”Per pagat e punonjesve mbeshtetes dhe punonjesve te tjere te specialiteteve te ndryshme ne disa institucionet te administrates publike.
- m. VKM nr .624,date 28.09.2022,”Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr 350,date 19.04.2017 ,”Per trajtimin dhe shtesa mbi page te punonjesve te sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”.
- n. VKM nr.604,date 14.09.2022 “ Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi.
- o. V.K.B Nr. 104, datë 28.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë”.

p. V.K.B Nr. 105 datë 28.12.2022 "Miratimin e kategorizimin e nivelit te pagave te Aparatit te Bashkise,Njesive Administrative Dhe institucioneve ne varesi te saj per Vitin 2023".

Planifikimi i Buxhetit 2023 është bazuar në:

- ☛ Përmirësimin e Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale.
- ☛ Integrimin Territorial dhe Barazinë në Shërbime e Akses.
- ☛ Konkurueshmërinë dhe Zhvillimin Ekonomik.
- ☛ Cilësinë e lartë të jetesës dhe Zhvillimin Urban.
- ☛ Mbrojtjen e Mjedisit dhe Aftësinë për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore.

Buxheti 2023 synon:

- ✓ Prioritet për investime të miratuara në PPV dhe të konsultuara, në fushen e infrastrukturës publike.
- ✓ Vlerësimin e projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike.
- ✓ Qasje të reja në fusha të ndryshme si administratë, investime, procese politike dhe jetë publike që përkthehet në implementim konkret të objektivave të barazisë gjinore në nivel qeverie vendore.

Buxheti i vitit 2023 sipas 18 programeve buxhetore paraqitet si më poshtë:

Nr.	Programet buxhetore	Buxheti në lekë 2022	Buxheti në lekë 2023	Diferencia ne leke	Ndryshimi ne %
0 1110	Planifikimi ,Menaxhimit Administritmt	149,595,397	140,360,417		
0 3140	Sherbimet e Policise	5,462,000	4,824,600		
0 3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	18,207,057	15,721,377		
0 3280	Emergjencat Civile	1,500,000	1,500,000		
0 4240	Menaxhimi i infrastukturës së uijtjes dhe kullimit	19,705,601	23,301,916		
0 4260	Administrimi i Pyjeve dhe kullotave	25,045,199	25,122,824		
0 4520	Rrjeti rrugor rural	124,207,516	182,857,086		
0 5100	Menaxhimi i mbetjeve	9000,000	9,000,000		
0 6260	Shërbimet Publike	37,126,300	30,300,928		
0 6260	Shërbimi i Pastrimit	32,397,081	32,571,017		
0 6370	Furnizimi me uje		21,000,000		
0 8130	Sport dhe argëtim	12,000,000	12,000,000		
0 8220	Trashëgimi kulturore,evenete artistike dhe kulturore	10,794,674	8,285,356		
0 9120	Arsimi,baze dhe parashkollar	116,881,810	107,179,568		
0 9230	Arsimi Mesem i per gjithshem	3,283,271	3,411,671		
10430	Kujdesi social për personat e sëmurrë dhe me aftësi të kufizuar (Qendra Ditore femij eve me AK)	4,904,550	6,139,652		
10430	Çerdhja e femijeve	13,710,000	13,929,848		
10430	Manca sociale	0	1,120,000		
6190	Strehimi	3,000,000	2,940,000		
04980	Fond Rezerve /Kontigjence	10,935,112	13,093,180		
10140	Tungjatjeta jete	1,680,000	0		
TOTALI I BUXHETIT:		599,435,568	654,659,440	55,223,872	10.5

Per vitin 2023 totaali i burimeve shkon ne vlerën 654,659,440 leke dhe kahasuar me buxhetin baze te vitit 2022 kemi nje rritje ne vleren 55,223,872 leke ose rrithet 10.5 %.

- Zëri fond rezerve është planifikuar 2% e totalit të buxhetit .

Parashikimi i të ardhurave është bazuar në:

- Administrimin dhe dhënien e shërbimeve ndaj qytetarëve në të gjithë territorin e saj, si një mekanizëm kyç për mbledhjen e detyrimeve vendore të bizneseve dhe individëve.
- Shfrytëzimi dhe dhënia në eficencë i aseteve të veta.
- Politika lehtësuese, taksa të ulëta dhe rritja e frysës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimi dhe standartizimi i procedurave, trajtimi i qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të Bashkisë.

Procesi i planifikimit të të ardhurave synon :

- Taksim të drejtë
- Tarifim të mbështetur në kosto shërbimi
- Klasifikimin e biznesit sipas llojit të aktivitetit, vendosjes etj.
- Aplikimi i lehtësirave fiskale, përjashtimeve për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë aq sa lejon dhe parashikon ligji.

Të ardhurat sipas burimeve buxhetore

PLANI I TË ARDHURAVE	VITI 2022	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025
Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	153,610,000	166,861,000	172,298,000	177,281,000
Të ardhura tatimore	54,260,000	57,820,000	59,902,000	61,291,000
Të ardhura jo tatimore	99,350,000	109,041,000	112,396,000	115,990,000
Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar	287,603,230	330,723,278	330,723,278	330,723,278
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	151,142,338	157,075,162	157,075,162	157,075,162
TOTALI I TË ARDHURAVE	599,355,568	654,659,440	660,096,440	665,079,440

Sic shihet nga tabela e mesiperme per vitin 2023 kemi rritje te burimeve financiare kahasuar me vitin 2022 ne vleren 55,223,872 leke ose 10.5%.

Burimet e veta që Bashkia Librazhd ka planifikuar të realizojë për vitin 2023 zënë 25.4% të totalit të të ardhurave të përgjithshme. Për vitin 2024 burimet e veta pritet të zënë 26.1% të totalit të të ardhurave të përgjithshme, ndërsa për vitin 2025 pritet të zënë 26.7% të totalit të përgjithshëm të të ardhurave.

Të ardhurat nga Buxheti Qendoror për vitin 2023 zënë rrëth 74.6% të totalit të burimeve të financimit. Nga këto burime 50.5% e zë transferta e pakushtëzuar, 24.1% zë transferta e pakushtëzuar sektoriale. Për vitin 2024 zënë 73.9% të totalit të përgjithshëm të Buxhetit, konkretisht 50.1% transferta e pakushtëzuar, 23.8% transferta e pakushtëzuar sektoriale. Për vitin 2025 zënë 73.3%, konkretisht 49.7% transferta e pakushtëzuar dhe 23.6% transferta e pakushtëzuar sektoriale.

Parashikimi i te ardhurave te Bashkise per vitin 2023 eshte bere duke u bazuar ne ligjet , VKM ,udhezimet , si dhe Vendimit te Keshillit Bashkiak Nr. __ date 14.11.2022 “Per miratimin e Paketes Fiskale 2023” dhe konfirmim akti nga Prefektura e Qarkut Elbasan .

Ne planifikimin e sakte te te ardhurave jemi bazuar :

- Ne realizimin e te ardhurave faktike Janar – Nentor 2022 , i pritshmi Dhjetor 2022.
- Ne nivelin taksave dhe tarifave te percaktuara sipas Vendimit te Keshillit Bashkiak per cdo lloj aktiviteti .

Ky parashikim i te ardhurave te buxhetit te vitit 2023 synon sigurimin e burimeve financiare te mjaftueshme per mbulimin e shpenzimeve .

Plani i te ardhurave te Bashkise Librazhd per vitin 2022 eshte ne vleren 166,010 mijë leke. (*bashkelidhur tabela Nr. 1 me planifikimin e te ardhurave per vitin 2023 dhe parashikimi per vitet 2023-2025 , tabela , tabela Nr 3 buxheti mujor per vitin 2023*).

Per vitin 2023 plani i te ardhurave te bashkise parashikohet ne vleren 166,861 mijë leke i detauar si me poshte.

Planifikimi i te ardhurave per vitin 2023 .

Tabela nr. 2

Nr	Lloji i takses dhe tarifes	Parashikimi 2023 /000 leke
<i>Te ardhura tatimore</i>		
<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>		
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogel	1820
2	Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale	5000
3	Taksa mbi ndertesat	16000
4	Takse mbi truallin	600
5	Takse toke buqesore	5450
6	Taksa e kalim te drejtës se pronesise	200
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukturre ndertimet e reja	10100
8	Taksa e ndikimit ne infrastrukturre legalizimet	3000
9	Takse table	620
10	Takse hoteli	170
11	Taksa e regjistrimit per vitshem te automjeteve	14500
12	Takse nga Renta	360
		57820
<i>Te ardhura jo tatimore</i>		
<i>Te ardhura nga tarifat vendore</i>		
1	Tarife pastrimi	18200
2	Tarife ndricimi+Gjelrimi	3500
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	120

4	Tarifa e sherbimit veterinar	200
5	Tarife e tregut te organizuar	1200
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	60
7	Tarife parkimi	1300
8	Tarife per dhenie license e certifikate transporti	500
9	Tarife per leje te drejta , vertetime,informacione	750
10	Tarife per zenien e hapsires publike	2150
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	400
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet.	1000
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	1650
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	430
15	Tarife per mbetjet inerte	210
16	Tarifa për ndikimin ne mjesdis	7000
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	550
18	Interesa kamatvonesa, gjoba (taksa)	1000
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	17000
	Shuma	57220
	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave	
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	12700
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	350
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	21500
4	Nga shfrytezimi I druve te zjarrit nga fshataresia	5600
5	Nga shfrytezimi I prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	300
6	Te ardhura nga perdonimi vertetimeve te transportit kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	620
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	200
	Shuma	41270
	Te ardhura te tjera	
1	Qera e shitje trualli	600
2	Qera ndertese , qera ndertese nga privatizimet	370
3	Pagesa e prinderve çerdhe	1400

4	Pagesa e prinderve kopesht	5140
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet cerdhe dhe qendra ditore	916
6	Gjoba nga I.N.U.V, policia	2050
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	75
8	Sponsorizime	0
9	Tarife akte ligjore e administrative (shitje skrap etj)	0
	Shuma	10551
	TOTALI	166,861

Te ardhurat per vitin 2023 jane planifikuar ne masen 166,861 mijë leke
Me poshte po shpjegojme sipas zerave te te ardhurave .

Te ardhurat tatimore nga Taksat.

Taksa e Tatimit mbi te ardhurat personale eshte planifikuar 5000 leke.

Planifikimi nga tatimi mbi te ardhurat eshte 2 % e shumes totale nga 13 %

Taksa mbi ndertesat

Jane planifikuar 100 mijë m² ndertesa per njesi sherbimi , 205 mijë m² apartament banini ne qytet dhe 170 mijë m² siperfaqe ndertese ne 6 njesite administrative .

Nga keto 100 mijë m² jane nga biznesi si ne qytet ashtu edhe nga 6 njesite administrative ne vleren 10,300 mijë leke , 375 mijë m² ne vleren 5,700 mijë lek per objektet per banim (familjaret).

Llogaritia e takses se nderteses eshte bere sipas Ligjit 9632 date 30.10.2006 i ndryshuar me ligjin nr 106/2017, VKM nr 132 date 07.03.2018 ku sipas ketij ligji baza e takses mbi ndertesat eshte vlera e ndertesave dhe kjo takse aplikohet si perqindje mbi bazen e takses neni 21 , ku percaktohet se Keshilli Bashkiak vendos per nivelin e takses, qe do te zbatohet per cdo kategori minimale te bazes takses, ne kufijte plus /minus 30 per qind te nivelit tregues takses per kategorite perkatese.

Per taksen e ndertesave per vitin 2023 eshte planifikuar 16000 mijë leke

Plani per 2023 eshte rritur pasi jane rregjistruar nje numer i konsiderueshem i siperfaqeve te ndertesave , si dhe siperfaqet e legalizuara te regjistruara ne ASHK, te verifikuara ne terren etj .

Nga 81 mijë m² siperfaqe ne vitin 2022 shkon ne 100 mijë m² per vitin 2023.Mendojme te rrisim bazen e taksueshme per ndertesat (numri i ndertesave te taksueshme).Siperfaqet e ndertesave per banim per vitin 2023 shkon 375 mijë m² nga 288 mijë m² ne vitin 2022.

Taksa mbi truallin per vitin 2023 eshte planifikuar ne masen 600 mijë leke qe llogaritet truall funksional si ne qytet ashtu dhe Njesite Administrative.

Taksa mbi Token Bujqesore

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori dhe planifikimi per kete eshte 4500 ha toke bujqesore ne vleren 5450 mijë leke per vitin 2023.

Taksa e kalimit te drejtes se pronesise.

Per vitin 2023 eshte planifikuar ne masen 200 mijë leke taksa e kalimit te drejtes se pronesise paguhet nga firmat ndertuese , subjektet juridike qe kryejne transaksione te shitjes dhe nga informacioni i marre nga ASHK.

Taksa e ndikimit ne infrastrukturre nga legalizimet

Ne kete vlere eshte perfshire taksa e ndikimit ne infrastrukturre per ndertimet e trajtuara me leje legalizimi dhe per vitin 2023 eshte planifikuar 3 miljon leke kjo referuar vitin aktual qe jane legalizuar nga ASHK .Procedura e marrjes se certificates se pronesise jepet nga ASHK dhe pa u paguar taksa e infrastrukture gje qe ka ulur dhe nivelin e pageses se kesaj takse .

Taksa e tabeles

Per vitin 2023 eshte planifikuar ne masen 620 mijë leke , bazuar kjo te subjekteve qe kane vendosur tabele si bankat subjektet.Theksojme se ne baze te ligjit per tabelen deri ne 2m² taksimi 0 dhe maximumi sip eshte deri ne 35 m² .

Takse Hoteli per vitin 2023 eshte planifikuar ne masen 170 mijë leke per 8 subjekte Parashikimi behet duke marre per baze rregjistrin e bizneseve ku jane te regjistruala per cdo nate fjetje ne hotel .

Taksa e Regjistrimit te pervitshem te Automjeteve jane planifikuar me rritje 14500 mijë leke duke marre si baze arketimet e vitit 2022 te regjistrimit te makinave per vitin 2022.nga taksa e rregjistrimit , DTRR per bashkine perkatese xhiron 25 % te vleres .

Taksa nga Renta

Rente paguajne subjektet minerare qe xhirohet 5 % e vleres se rentes nga dogana per importet dhe ekspotete e minerareve , Kjo takese eshte planifikuar 360 mijë leke duke marre si reference dhe derdhjete vitit 2022 .

Tarifa e pastrimit.

Tarifa e pastrimit perben 10.9% te planit te ardhurave te Bashkise per vitin 2023 eshte parashikuar ne vleren 18 miljon e 200 mijë leke. Pageses per tarifen e pastrimit i nenshtrohen subjektet e biznesit te vogel te madh,institucionet dhe familjaret,sipas niveleve te tarifave te percaktuara ne paketen fiskale,sipas Vendimin e K.B datë 14.11.2022 kategorizimeve përkatëse,te bazës se të dhënavë të krijuara,për numrin e subjekteve te biznesit te vogel,te madh dhe institucioneve që ushtrojnë aktivitet, ne teritorin e Bashkise Librazhd,si dhe numrit te familjeve që banojnë brenda territorit të Bashkisë Librazhd që i nënshtrohen tarifës së pastrimit ne shkembim te sherbimit te marre .

/000 leke

1	Per cdo subjekt te biznesit te vogel te artikujve industriale , artikujve te ndryshem kafe , bar- kafe, sherbime (kepuçar , rrobaqepes , parukeri etj).(+njesite administrative)	259	1,813
---	--	-----	-------

2	Per cdo subjekt te biznesit te vogel qe ndodhet ne zonen pedonale (zona A)	30	330
3	Per cdo subject te biznesit te vogel te artikujve ushqimore , fruta perime ,bulmet bar- restorante , bujtina, profesione te lira, prodhim, shitje lende ndertimi , inerte , ndertim , projektime , zbatime, konsulence .	203	1,773
4	Per cdo subjekt te biznesit te vogel qe ushtrojne aktivitet me nje nipt dy aktivitetete ne te njejten vendodhje .	10	160
5	Per niptet sekondare dhe subjektet e biznesit te madh qe kane seline ne Bashkite e tjera (ose jane me kontrate te lidhur me Bashkine Librazhd)	2	240
6	Per subjektet e biznesit te madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit, ne zonen pedonale	1	300
7	Per biznesin e madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit, jashte pedonales .	3	600
8	Per subjektet te biznesit te madh te regjistruar ne regjistrin e biznesit si bankat .	4	800
9	Per cdo subjektet e biznesit te madh i regjistruar ne regjistrin e biznesit si : fondacionet.	5	300
10	Per cdo njesi shitje te biznesit te madh ,ushqimore bar – restorant , baste sportive , hotele , motele bujtina .	12	960
11	Per cdo subjekt i profesioneve te lira, farmaci , te biznesit te madh.	10	500
12	Per cdo njesi shitje te biznesit te madh materiale ndertimi, shitje lende drusore, industriale , kabllore , internet.	44	3,320
13	Per cdo njesi prodhimi te biznesit te madh, fasonet .	11	1,650
14	Per kompanite e sigurimit me nipte sekondare dhe subjektet e biznesit te madh qe kane vetem seline ne Bashkine Librazhd	2	50
15	Per cdo firme ndertimi per seline administrative Bashkia Librazhd	4	240
16	Per subjektet e transportit mallit te biznesit te madh.	4	120

17	Per subjektet e transportit te udhetareve te biznesit te madh.	4	100
18	Per cdo njesi shitje karburanti dhe gazi te lenget te biznesit te madh.	7	600
19	Per ndermarrjet dhe institucionet shteterore Per ndermarrjet dhe institucionet jo shteterore qe kryejne sherbime dhe realizojne te ardhura	21	662
20	Per tregtaret brenda tregut me kontrate me Bashkine	25	3
21	Per OFJ dhe shoqatat	6	50
23	Per ambulantet	16	32
24	Pastrimi, largim mbeturinash (familjaret)	1900+ 2800 njesi	3,250
25	Pastrimi, largim mbeturinash, per familjet me ndihme ekonomike, invalidet, te vtmuarit dhe veteranet e luftes.	579	347
	Shuma		18, 200

Tarifa e Ndrincimit dhe e Gjelberimit

Pageses se tarifes se gjelberimit dhe ndricimit i nensstrohen te gjithe subjektet e biznesit te vogel ,subjektet e biznesit te madh institucionet dhe familjaret,qe ushtrojne veprimtarine ekonomike (per subjektet) ne Njesine Administrative Librazhd dhe familjaret e kesaj njesie.

Llogaritja e planit te tarifes se ndricimit dhe gjelberimit per vitin 2023.

		Vlera/000
1	Per cdo subjekt te biznesit te vogel shitje, prodhim dhe sherbime transporte etj	365
2	Per cdo subjekt te biznesit te vogel ne pedonale, profesione te lira, prodhimi, projektim, konsulencje, etj	95
3	Per cdo subjekt te biznesit te madh, institucionet shteterore dhe jo shteterore.	98
3	Tarifa e ndricimit ,gjelberimit per cdo familje	1900
5	Tarife ndricimi dhe gjelberimit per familje me ndihme ekonomike, invalidet, (kane 1 pjesetar te familjes) te vtmuarit	600
	Shuma	3500

Tarife per zenien e hapsires publike

Tarifen e paguajne te gjithe bizneset qe shfytezojne hapesirat publike jashte objektit te regjistruar me certifikate pronesie e per vitin 2023 planifikohet vlera prej 2 milion 150 mijë leke si me poshte ;

Biznese ne pedonale me sip. 647 m² ne vleren 1553 mijë leke

Karburante me sip. 100 m² me vlore 180 mijë leke

Biznese ne zonen "c" dhe njesite 26 biznese dhe njesite me vlore 417 mijë leke pasi me pakete fiskale rritja e cmimit nga 60 lek /m ne 100 lek/ m² .

Tarife per mbetjet inerte

Planifikimi per vitin 2022 eshte 210 mijë leke per subjektet qe mbetjet mbas ndertineve ti hedhin ne venddepozitimet e percaktuara sipas VKB per peshen 1200 ton ne vit.

Tarife sherbimi ne varrezat publike

Per vitin 2022 jane planifikuar 120 mijë leke per 2 subjekte qe kryejne aktivitet te tille .

Tarifa e sherbimit veterinar

Per vitin 2023 planifikimi eshte 200 mijë leke, eshte bere ne baze te regjistrat qe ka mbajtur subjekti i thertores me numer kreresh per te imta dhe te trashe per periudhen Janar – dhjetor 2022 .

Tarife e tregut te organizuar

Kjo taksë realizohet nëpërmjet vjeljes së të ardhurave mujore për tregtarët që tregtojnë brenda tregut sipas kontratave vjetore për vendet e zena ne tregun e qytetit ku per vitin 2022 jane lidhur 25 kontrata Gjithashtu te ardhurat nga biletat ditore për tregtarët që tregtojnë jashtë kapanoneve te tregut,të cilët i nënshtrohen biletës ditore.

<i>ne/ 000leke</i>		
<i>Nr</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Planifikimi</i>
1	<i>Tregtare me kontrate</i>	432
2	<i>Tregu ditor me bileta</i>	768
	<i>Shuma</i>	<i>1200</i>

Tarifa leje per tregetim ambulatore

Kjo e ardhur vjen nga tregtaret ambulatore qe marrin leje per ushtrim aktiviteti , aktualisht jane 14 subjekte ambulatore .

<i>Emertimi</i>	<i>Vlera / 000leke</i>
<i>Leje ambulatore</i>	<i>40</i>

Tarifa e parkimit

Tarifen e parkimit e paguajne te gjithe subjektet e transportit qe sigurojne parking ne hapesirat publike ne territorin e Njesise Administrative Librazhd

Subjekte transporti per linjat rrethqytetase kemi 43

Subjekte transporti per linjat nderqytetase kemi 3

Subjekte transporti per lic. Takxi 8 (4+1 dhe 8+1) .

/000 leke

<i>Tarife parkimi nga biznesi i madh</i>	<i>320</i>
